

VENDIM
Nr.366, datë 10.5.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BRENDSHME, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË NJË SPOTI
PUBLICITAR PËR INFORMIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË NË KUADËR TË
PROCESIT TË LIBERALIZIMIT TË VIZAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, për programin “Policia e Shtetit”, t’i shtohet një fond në shumën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të një spoti publicitar për informimin e shtetasve shqiptarë në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3.Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha